



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Në vijim të kërkesës Tuaj datë 14.01.2026, Ju informojmë si më poshtë vijon:

1. *A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2025?*

Gjatë vitit 2025, Bashkia Shkodër ka ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse përmes formave të ndryshme të financimit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat në fuqi. Procedurat e përdorura nga Bashkia Shkodër kanë qenë të ndryshme dhe kanë përfshirë, ndër të tjera: marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe, procedura prokurimi me vlerë të vogël, thirrje të hapura për paraqitjen e projekt-propozimeve në fushën artistike dhe kulturore, në bashkëpunim me Këshillin Artistik-Kulturor, si dhe përjashtime nga detyrimet tarifore. Gjithashtu, mbështetja financiare është realizuar edhe përmes transfertave specifike në fusha si shërbimet sociale, zhvillimi ekonomik dhe turizmi, në funksion të realizimit të politikave dhe prioriteteve të Bashkisë Shkodër.

2. *Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2025? Ju lutem specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur më shumë së një formë.*

- Për aktivitetet artistike – kulturore kanë përfituar mbështetje financiare 23 OJF, për aktivitete sportive – 16 OJF, për aktivitete promovimi – 2 OJF sipas procedurës për projekt propozime me Këshillin artistik kulturor. Kontratat e shërbimit me OJF-të në fushën e kulturës, artit, sportit dhe promovimit monitorohen nga grupet e monitorimit të ngritura me urdhër të titullarit për çdo projekt të realizuar sipas kushteve të kontratës.
- Për shërbimet sociale kanë përfituar mbështetje financiare 2 OJF.
- Me procedurë prokurimi kanë përfituar mbështetje financiare 2 OJF.

3. *Cili ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem specifikoni sipas formës në ka patur më shumë se një formë.*

Nr	Përfituesi - OJF që ka zbatuar aktivitetin/fondin	Fondi (lekë)
Procedura: Këshill artistik kulturor – aktivitete kulturore		
1	Shoqata Kulturore “Prenkë Jakova”	688.000
2	Shoqata Viktoria	548.000
3	Qendra MERS@art	910.000
4	Shoqata Antik	8.000.000
5	Shoqata Kulturore Pulcinela	1.350.000
6	Albania Community Assist	2.180.000
7	Shoqata Kulturore “Prenkë Jakova”	600.000
8	Shoqata Sinfoart	2.000.000
9	Albania Initiative for Developmnet	400.000
10	Faondacioni “Art House”	800.000
11	Shoqata "Syri Blu"	400.000
12	Qendra ZA	2.000.000
13	Fondacioni "Bota Ndryshe"	6.000.000
14	Fondacioni "ARTE"	2.000.000
15	Shoqata Kulturore "Rrok Jakaj"	1.500.000
16	Think Creative Idea	700.000
17	Shoqata Kulturore Artsistike "TREVA"	110.000
18	Shoqata "Ejan ne Teater"	722.000
19	Shoqata "Pena E Shkodres"	290.000
20	Shoqata "Shigjeta Creative"	400.000
21	Shoqata "Dimension Human"	300.000
22	Qendra Social kulturore "Edukojme me art"	700.000
23	Doinalbania	7.000.000

Nr	Përfituesi - OJF që ka zbatuar aktivitetin/fondin	Fondi (lekë)
Procedura: Këshill artistik kulturor – aktivitete promovimi		
1	Shoqata "Dimension Human"	700.000
2	Shoqata “The Door”	500.000

Nr	Përfituesi - OJF që ka zbatuar aktivitetin/fondin	Fondi (lekë)
Procedura: Këshill artistik kulturor – aktivitete sportive		
1	Shoqata Atletikë Vllaznia	5,500,000
2	Shoqata Sportive e Boksit "Shkodra Boks"	4,700,000
3	Shoqata Sportive e Ping Pongut Vllaznia	650,000
4	Shoqata Sportive Judo Vllaznia	2,200,000
5	Shoqata Shkodra Not	650,000
6	Klubi i çiklizmit Shkodra	2,350,000
7	Shoqata e Gjimnastikës	800,000
8	Unioni i Shahistëve të Veriut	650,000
9	Shoqata Sportive e Basketbollit Vllaznia	10,000,000
10	Shoqata Volej Vllaznia	10,200,000
11	Shoqatës së Futbollit të Femrave Vllaznia	2,000,000
12	Shoqata Future Sports Academy Shkodër 2022	1,000,000
13	Shoqata "Veriu i Shkodrës 2021"	800,000
14	Shoqata Sportive "Vllaznia-Mundje"	800,000
15	Shoqata e Arteve Marciale Vllaznia Taekwondo	900,000
16	Shoqata Futsal Vllaznia	800,000
Procedura: Transfertë e pakushtëzuar sektoriale		
25	Projekti "Shpresa"	24 971,000
26	Madonnina della Grappa	19 532,000
Procedura: Honorare për instruktorët dhe punonjësit social të trupës muzikore Transport për trupën muzikore		
27	The Door	369,000
Procedura: Procedurë Prokurimi		
28	Aarhus Information Centre Shkodër	120,000
29	Shpresa për të ardhmen	354,400

4. Keni ofruar mbështetje jo financiare gjatë vitit 2025? Cila është baza ligjore/rregullatore që rregullon këtë formë mbështetje.

Për vitin 2025, përveç mbështetjes financiare, kemi ofruar gjithashtu mbështetje jo financiare për Organizatat Jofitimprurëse(OJF), siç është përjashtimi nga tarifat e zënies së hapësirave publike. Ky përjashtim është parashikuar edhe në paketën fiskale, e cila është përcaktuar në aktin normativ të miratuar me VKB nr. 1, datë 22.01.2016, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër,” i ndryshuar. Baza ligjore në të cilën mbështetet ky bashkëpunim është Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr.

8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar; Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 45/2016 Për vullnetarizmin; VKM nr. 822 datë, 06/12/2006 “Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar,në qendrat rezidenciale dhe ditore”; VKB Nr. 76, dt. 19.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025, dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar; Udhëzimi nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e Kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”; Si dhe një sërë ligjesh të tjera në varësi të fushës së bashkëpunimit.

5. *Nëse keni ofruar mbështetje jo-financiare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qënë lloji i mbështetjes jo-financiare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)?*

Mbështetja e dhënë ka për qëllim ofrimin e mundësive për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në hapësirat publike dhe ambientet pranë Bashkisë Shkodër. Kjo mbështetje përfshin organizimin e aktiviteteve sociale, ekonomike dhe kulturore, si dhe ofrimin e hapësirave për trajnime. Njëkohësisht, është ofruar edhe përjashtim nga detyrimet tarifore për përdorimin e hapësirave publike, për aktivitetet që zhvillohen në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit përkatës.

6. *Cili është numri i takimeve monitoruese nga numri total i projekteve fituese që keni kryer gjatë 2025? Ju lutem na siguroni një listë të kriterëve monitoruese.*

Gjatë vitit 2025, projektet fituese të financuara nga Bashkia Shkodër janë ndjekur përmes një procesi monitorimi të vazhdueshëm, në përputhje me kushtet e kontratave të shërbimit dhe procedurat e brendshme të institucionit. Monitorimi është realizuar nga grupet e monitorimit të ngritura me urdhër të titullarit për secilin projekt, përmes takimeve monitoruese, komunikimeve zyrtare dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës. Numri i takimeve monitoruese është përcaktuar në varësi të natyrës, kohëzgjatjes dhe specifikës së çdo projekti, duke garantuar ndjekjen e zbatimit të tyre gjatë gjithë periudhës kontraktuale.

Sa i përket kriterëve të monitorimit, grupet përkatëse janë bazuar në elemente të përgjithshme vlerësimi që lidhen me përputhshmërinë e zbatimit të projekteve me kushtet kontraktuale, ecurinë e aktiviteteve të planifikuara dhe dokumentacionin shoqëruar të paraqitur nga organizatat përfituese, në funksion të verifikimit të realizimit të projekteve dhe përdorimit të rregullt të fondeve publike.

7. *A është bërë një vlerësim impakti mbi fondin e disbursuar ndaj organizatave jofitimprurëse? A keni një raport të tillë vlerësimi? Nëse po, ju lutem bashkëngjisni atë.*

Procesi i ndjekur nga Bashkia Shkodër për financimin e organizatave jofitimprurëse parashikon mekanizma monitorimi dhe raportimi gjatë zbatimit të projekteve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse të financimit.

Vlerësimi i zbatimit të projekteve dhe i përdorimit të fondeve realizohet përmes dokumentacionit periodik të dorëzuar nga subjektet përfituese dhe verifikimeve administrative të kryera nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Shkodër.

Dokumentacioni i administruar pasqyron ecurinë dhe rezultatet e projekteve të financuara, në raport me objektivat e miratuara.

8. *Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2025?*

Numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni ynë gjatë vitit 2025 është tetë (8).

9. *A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.*

Personi në ngarkim për konsultimet publike në bashkinë Shkodër është Z. Bekim Mema, me adresë emaili Bekim.mema@bashkiashkoder.gov.al

10. *A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.*

Bashkia Shkodër koordinon aktivitetet e shoqatave përmes drejtorive përkatëse, të cilat merrem me fushat specifike të veprimtarisë. Çdo drejtori është përgjegjës për menaxhimin e bashkëpunimit me shoqatat e fushës përkatëse, dhe stafi i drejtorive është trajnuar për të ofruar mbështetje dhe koordinim në këtë drejtim.

11. *Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga Institucioni juaj?*

Ky informacion nuk është i detajuar.

12. *Sa Përqind (%) e projektligjeve/akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-të?*

Ky informacion nuk është i detajuar.

13. *A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse po cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshira në to?*

Bashkia Shkodër, në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ka ndërmarrë hapa për përfshirjen e përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse dhe të shoqërisë civile në procese dhe struktura këshillimore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

i. Buxhetimi me pjesëmarrje

Konsultimi i buxhetit të Bashkisë për programet buxhetore përbën një objektiv të rëndësishëm të Bashkisë Shkodër, me synim përfshirjen e shoqërisë civile, komunitetit, bizneseve dhe grupeve të tjera të interesuara. Ky proces synon rritjen e transparencës dhe sigurimin që vendimmarrja dhe alokimi i burimeve publike të pasqyrojnë nevojat dhe prioritetet reale të qytetit.

Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje realizohet në zbatim të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, duke ndjekur të gjithë hapat e parashikuar në këtë ligj. Informacioni përkatës publikohet dhe është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, në rubrikën “Këshillim me Publikun”, ku përfshihen njoftimet për konsultim publik, kalendari i konsultimeve dhe procesverbalet e takimeve publike.

ii. Fusha e turizmit

Në fushën e turizmit, Bashkia Shkodër organizon tryeza konsultimi dhe diskutimi, të cilat shërbejnë si platformë bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë, institucioneve arsimore, subjekteve të biznesit në sektorin e turizmit dhe organizatave të shoqërisë civile, me qëllim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në territorin e bashkisë.

iii. Këshilli Vendor i Rinisë

Pranë Kryetarit të Bashkisë funksionon Këshilli Vendor i Rinisë, si organ këshillimor, në përbërjen e të cilit përfshihen përfaqësues të rinjve dhe organizatave rinore, me qëllim përfshirjen e tyre në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse që lidhen me politikën rinore.

14. A janë përfshirë OJF në grupet e punës së ngritura të institucionit tuaj/ Nëse po, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshira në to?

Në fushën e shërbimeve sociale – Bashkia Shkodër ka të ngritura 12 qendra komunitare "Për familjen" të shtrira në 5 lagjet e qytetit, në disa njësi administrative si dhe shërbimi lëvizës në njësitë administrative të tjera. Qendrat e Bashkisë Shkodër janë hapura dhe po bashkëpunojnë shumë mirë me donatorët dhe OJF që janë të lidhura direkt me fushën e rinisë, duke realizuar MoU të cilat janë transparente dhe të aprovuara në Këshillin Bashkiak. Disa nga organizatat e angazhuara janë: Save the children, World Vision, Qendra Rinore Arka, Young Entrepreneurs Abania.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI